
Lënda: Informacion i pjesshëm në lidhje me inspektimin e objekteve të finacuara nga Bashkia Tiranë për periudhën kohore nga viti 2010 deri në vitin 2018

Objekti: Rikualifikimi urban, blloku i kufizuar mes rrugëve "Dervish Hima", "Sheh Ahmet Pazari" dhe stadiumit Qemal Stafa, në Njësinë Bashkiake Nr. 2

Investitori: Bashkia Tiranë
Vlera e Investimit: 47,232,082 lekë
Periudha kohore: Nëntor 2014, deri në qershor 2016
Inspektimi është kryer: Shkurt 2019

Ky objekt është zbatuar brenda zonës së qytetit të Tiranës, në një bllok banimi në anën Lindore të ish-stadiumit "Qemal Stafa", pjesë e Njësisë Administrative Nr. 2, Bashkia Tiranë. Blloku i banimit ku është investuar kufizohet midis rrugës "Dervish Hima", rrugës "Sheh Ahmet Pazari", rrugës perreth ish-stadiumit "Qemal Stafa", pjesë e Njësisë Bashkiake Nr. 2, me një sipërfaqe të përgjithshme të këtij blloku banimi me rreth 10,000 m² (sipërfaqja e shënuar përfshin ndërtesat, rrugët, sheshet, trotuaret, sipërfaqet e lira, etj.). Gjendja ekzistuese e infrastrukturës së bllokut të banimit në momentin e investimit ka qenë pjesërisht e amortizuar. Është një zonë banimi e vjeter, me ndërtime të ulta banimi, si edhe ndërtime të reja, të kryera kryesisht pas viteve 2000.

Projekti ka ndërhyrë në rikonstruksionin e pjesshëm të rrugës "Sheh Ahmet Pazari", si edhe të segmentit rrugor që lidh këtë segment rrugor, me rrugën në anën Lindore të Stadiumit "Qemal Stafa", duke përfshirë rikonstruksionin e shtresave rrugore të rrugëve kryesore (shtrimin me "binder" dhe shtrimin me asfalt të tyre, plus nënshtresat), në rehabilitimin e rrjetit të ujërave të bardha dhe të zeza, me rikonstruksionin e të gjitha pusetave të ujërave të bardha e të zeza, në sistemimin e plotë të trotuareve, bordurave anësore të rrugëve, në rehabilitimin e rrjetin të ndriçimit, në sinjalistikën rrugore, në sistemimin e një hapësire që shërben për parkim të jashtëm të banorëve, etj. Projekti i zbatimit ka parashikuar një rehabilitim të pjesshëm të këtij blloku banimi. Është një zonë banimi, kryesisht me pallate banimi 8 dhe 10 katësh, si edhe me ndërtime të reja, pallate të ndërtuara vitet e fundit (pallati 22 katësh), me infrastrukturë rrugore pothuajse të dëmtuar.

Punimet kanë filluar rreth muajit nëntor të vitit 2014, e kanë përfunduar në muajin qershor 2016, që përkon edhe me përfundimin e deklaruar nga Bashkia Tiranë. Duhet të përmendim se zbatimi i punimeve për këtë zonë banimi është bërë në kushte jo shumë optimale, pasi rrugët gjatë periudhës së rikonstruksionit, kanë qenë të bllokuara vetëm pjesërisht. Afati i garancisë së punimeve për objektin tashmë ka përfunduar (afati i garancisë së punimeve për këtë objekt është parashikuar të jetë dy vjet). Vlen të theksojmë se investimi në këtë bllok banimi ka qenë vetëm investim pjesor, duke kryer rehabilitimin e rrugës që lidh pallatin 22 katësh me rrugën kryesore "Dervish Hima". Theksojmë se rrugët e rikonstruktura i shërbejnë vetëm këtij blloku banimi, me lëvizje e trafik të brendshëm për banorët e tij.

Nga pamja vizuale e objektit konstatojmë se:

- ✓ Nuk konstatojmë lëvizje (ulje) apo plasaritje të trupit të rrugës;
- ✓ Në disa segmente ka sipërfaqe të shtresave të asfaltit, të cilat kanë filluar që të thërrmohen, kryesisht te segmenti që shërben si parkim (gjë që tregon se shtresa e asfaltit të hedhur nuk është material cilësor dhe sipas standardeve);
- ✓ Vihen re ulje dhe lëvizje të pllakave të trotuareve;
- ✓ Shtresa e betonit e kunetave anësore në disa pjesë të rrugës kanë plasaritje të dukshme. Ka diferencë të dukshme të cilësisë së markës së betonit të hedhur në kunetat anësore brenda të njëjtit segment rrugor;
- ✓ Bashkia nuk duket se ka një plan të mirëfilltë studimi, të miratuar për këtë zonë. Kjo vihet, pasi investimet e kryera nga ana e saj në këtë bllok banimi janë kryer pjesërisht dhe në periudha të ndryshme kohore. Edhe pse hapësira kryesore e bllokut të banimit ka qenë pjesë e aneksit të stadiumit "Qemal Stafa" (në funksion si fushë sporti), ajo tashmë është lejuar të shërbeje si parkim i jashtëm, duke e uzurpuar pothuajse plotësisht të gjithë hapësirën e fushës së sportit. Vetëm gjatë muajit janar 2019, bashkia inaguroi një kend të vogël lodrash (ngjitur me rrugën "Dervish Hima"), hapësirë e cila theksojmë se zë më pak se 5% të hapësirës totale së ish-Fushës së Sportit, ndërkohë që hapësira e lejuar për parkim (nga privatët) zë shumicën e kësaj hapësire.

Defektet e shfaqura në shtresat asfaltike të rrugës, trotuaret anësor të saj, heqja e lëndës së drurit dhe plotësimi me fuga i të gjithë shtresave prej betoni të kunetave, do duhej detyrimisht t'i bëheshin prezent firmës zbatuese të punimeve, nga specialistët përgjegjës pranë Bashkisë Tiranë. Vetëm pas riparimit të defekteve të shfaqura, Bashkia Tiranë do duhej të kryente ç'blokimin e garancisë së punimeve për këtë vepër. Ndërkohë që ky afat tashmë ka përfunduar.

Konkluzione në lidhje me objektin:

- *Të bëhet riparimi i uljeve të pllakave të parapërgatitura të trotuareve, duke zëvendësuar të gjitha pllakat e thyera në to;*
- *Të riparohen të gjitha kalimet për personat me aftësi të kufizuara në trotuare, për lidhje të njëtrajtëshme të tyre me trupin e rrugës dhe pa pengesa;*
- *Të bëhet riparimi i plotë i të gjitha pusetave të ujërave të bardha e të zeza (zëvendësimi i kapakëve të dëmtuar dhe betonit të dëmtuar përreth tyre);*
- *Bashkia Tiranë do duhet detyrimisht të rakordojë punën midis gjithë institucioneve përkatëse shtetërore (siç janë Ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizime Tiranë, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike apo ndërmarrjet në varësi të Bashkisë Tiranë) në mënyrë që kur të programohet investimi në rrugë apo në bllokun e banimit, të ketë një programim të qartë dhe jo të parcelizuar;*
- *Sipas mendimit tonë, vlera për riparimin e defekteve të vërejtura mendoj se zënë rreth 5 % të vlerës së situacionit përfundimtar.*

Për të gjitha vërejtjet e mësipërme jemi mbështetur në nenet e praktikave standarde të kontratave të zbatimit të punimeve, si edhe në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 3, datë

15.01.2001, nr. 2, datë 13.05.2005 dhe nr. 1, datë 16.06.2011, "Për mbikëqyerjen dhe kontrollin e punimeve të ndërtimit".

**Bashkëlidhur një foto ajrore e bllokut të banimit ku është kryer investimi
(me vijë blu është shënuar rruga ku është kryer rehabilitimi)**

